




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA | REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA PËR PARANDALIMIN E KORRUPSIONIT
AGENCIJA ZA SPRJEČAVANJE KORUPCIJE
THE AGENCY FOR PREVENTION OF CORRUPTION



Në mbështetje të nenit 9 paragrafi 1, nenit 5 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1., pika 1.1.1., nenit 12 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5. dhe nenit 22, paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, nenit 21 paragrafi 2 të Ligjit nr. 06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), nenit 11 paragrafi 4 dhe 5, si dhe nenit 12 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7. të Rregullores Nr. 03/2023, për Procedurat për Hetimet Administrative në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, me datë 08.07.2025, nxjerrë këtë:

V E N D I M

- I.** Mbyllet rasti me Nr.APK-DPKI-06-386/25, për zyrtaren znj. Ajkune Qorri, Zyrtare e Prokurimit në Komunën e Drenasit, për shkak se nuk ka prova që e argumentojnë dyshimin e arsyeshëm për ekzistimin e konfliktit të interesit sipas dispozitave të Ligjit nr.06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit.
- II.** Ky vendim është përfundimtar në procedurën administrative dhe i njëjti publikohet në uebfaqen zyrtare të Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

A r s y e t i m

Rasti i hapur me pretendime për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, është trajtuar sipas procedurës së paraparë me Ligjin Nr. 06/L-011, për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, pas pranimit të denoncimit nga një raportues i rastit, ka filluar procedurën e shqyrtimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve publike.

Denoncuesi i rastit ka ngrit pretendimet, citojmë nga kërkesa e raportuesit; *sipas të dhënave të siguruara nga regjistri për deklarimin e pasurisë për vitin 2023, Ajkune Qorri është Zyrtare e Prokurimit në Komunën e Drenasit, me datë 02.10.2023 në të njëjtën kohë, ajo udhëheq edhe procedurat e prokurimit edhe në Autoritetin Kontraktues të Komunës së Zveçanit. Raportuesi ka kërkuar nga Agjencia;*

- *Të shqyrtojë nëse mbajtja e dy pozitive të njëjta në dy autoritete kontraktuese të ndryshme nga e njëjta person është në përputhje me legjislacionin vendor.*
- *Të japë një interpretim ligjor mbi këtë situatë, duke marrë parasysh nenin 13 të Ligjit për parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se; Zyrtari i lartë nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një organi drejtues të ndërmarrjes në pronësi publike.*

shoqërisë aksionare me pronë publike si dhe organeve të institucioneve të tjera publike, përveç nëse parashihet ndryshe shprehimisht me ligj.

- *Të sqarohet se si të rregullohet kompensimi financiar në dy institucione publike në raste të tilla, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.*

Agjencia konform dispozitave të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit, e ka njoftuar zyrtaren për fillimin e procedurës për shqyrtimin e gjendjes së konfliktit të interesit. Zyrtarja është deklaruar se në Komunën e Zveçanit është angazhuar në kryerjen e aktiviteteve të prokurimit sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet Kryetarit të Komunës së Drenasit dhe Kryetarit të Komunës së Zveçanit.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit me qëllim të sqarimit të gjendjes faktike, ka kërkuar dhe pranuar dokumentacion përkitazi me rastin konkret.

Kryetari i Komunës së Drenasit dhe Kryetari i Komunës së Zveçanit me datë 27.07.2023 kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërkomunal në fushën e Buxhetit, Financave dhe Administratës së Përgjithshme, fushën e Prokurimit, Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe fushat e tjera varësisht nga nevoja e Komunës së Zveçanit.

Me datë 01.08.2023 është nënshkruar Marrëveshja për punën me vëllim të shtuar në kohëzgjatje një vjeçare, ndërmjet Kryetarit të Komunës së Zveçanit dhe zyrtares Ajkune Qorri për kryerjen e detyrave të aktiviteteve të prokurimit publik, e cila është vazhduar me datë 01.08.2024, me kohëzgjatje një vjeçare.

Bazuar në marrëveshjen për vëllim të shtuar, zyrtarja znj Ajkune Qorri për angazhimin e bërë në Komunën e Zveçanit përfiton shtesë mujore 20 % të pagës bazë.

Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duke u mbështetur në Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit, konstaton se; angazhimi i zyrtares Ajkune Qorri në Komunën e Zveçanit për kryerjen e detyrave të aktiviteteve të prokurimit publik, nuk është e ndaluar me Ligjin Nr.06/L011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Për më tepër, në nenin 23 paragrafi 3 të Ligjit për Prokurimin Publik shprehimisht thuhet;

“Dy apo më shumë autoritete kontraktuese të cilat kanë prokurime të pakta mund të arrijnë marrëveshje që të përcaktojnë personin e njëjtë si zyrtar të prokurimit”.

Agjencia, ka shqyrtuar pretendimin lidhur me dispozitën e nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, së cilës i është referuar raportuesi i rastit, por Divizioni i Prokurimit (në këto institucione), nuk konsiderohet organ drejtues i ‘institucionit’ (sikurse mund të jenë, p.sh.: bordet apo organet tjera drejtuese të institucioneve) në kuptim të dispozitës së sipërcituar (nenit 13, paragrafi 2, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit), prandaj e njëjta nuk mund të aplikohet në rastin konkret.

II Agjencia vendosi duke u bazuar në nenin 22 [Procedura administrative e Agjencisë për rastet e konfliktit të interesit], paragrafi 12 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit me të cilin është përcaktuar se: “Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkeljen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.”, si dhe paragrafin 15 të këtij neni, me të cilin është përcaktuar se: “Vendimet e Agjencisë në lidhje me konfliktin e interesit janë përfundimtare në procedurë administrative.”

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtares publike
- Drejtorit të DPKI- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)


Ylli Buleshkaj
Drejtör i Agjencisë për
Parandalimin e Korrupsionit

